



# Buletini Mjedisor

## MINISTRI I MJEDISIT MBRON PROJEKTBUXHETIN E 2017 PËR FUSHËN E MJEDISIT



Ministri i Mjedisit, Z. Lefter Koka prezantoi në Komisionin Parlamentar për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, projektbuxhetin e Ministrisë së Mjedisit për vitin 2017.

Në fjalën e tij Ministri Koka theksoi se “Buxheti i Ministrisë së Mjedisit për vitin 2017, shënon një rënie krahasuar me një vit më parë, por jo një rënie reale kjo, por për arsyen se pyjet gjatë vitit kalendarik 2016 kaluan në pronësi për t'u administruar nga pushteti vendor. Ndërsa për zërat që tashmë janë objekt i buxhetit të Ministrisë së Mjedisit është kërkuar një rritje afërsisht prej 400 milion Lek për buxhetin e Mjedisit gjatë vitit 2017”.

Ministri i Mjedisit në fjalën e tij para deputetëve të këtij Komisioni shpjegoi se pse fusha e menaxhimit të mbetjeve është vlerësuar si një fushë prioritare, që kërkon një mbështetje financiare nga buxheti i 2017. Siç tashmë njihet nga të gjithë, në Shqipëri janë në proces zbatimi dy projekte madhore: përfundimi i landfillit dhe inceneratorit të Elbasanit, si dhe është në procesin e përfundimit inceneratori i Fierit që pritet të inagurohet gjatë muajve të fundvitit 2016. Përfundimi dhe fillimi i funksionimit të tyre duke pasur tashmë një zinxhir të plotë të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri kërkon vëmendjen tonë, por sigurisht dhe një buxhet të sigurt në vijimësi.

Ministri Koka në fjalën e tij për të mbrojtur buxhetin e kërkuar nga Ministria që ai drejton theksoi se mjedisi ka një problematikë të trashëguar në vite, ndaj kërkon një rivlerësim dhe të buxhetit edhe pse

qeveria shqiptare në këto 3 vite ka mundësuar rritje disa herë të buxhetit krahasuar me vitet e mëparshme.

Ministri Koka theksoi se buxheti që i akordohet tre institucioneve të varësisë dhe përkatësisht Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, limiton këto institucione për të kryer si duhet misionin për të cilën ato janë krijuar.

Gjatë prezantimit të projekt buxhetit Ministri i Mjedisit vlerësuar vëmendjen dhe angazhimin konkret të qeverisë shqiptare ndaj Mjedisit.

Gjithashtu, Ministri Koka kërkoj dhe vëmendjen e ligjvënësve për një çështje prioritare, siç është Marrveshja e Parisit që është firmosur dhe nga shteti Shqiptar që ka marrë angazhim për uljen e reduktimit të gazrave deri në 2030-ën.

“Aktualisht sot në Shqipëri ne kemi përlogarit një kosto për angazhimin tonë sa i përket zbatjes së efekteve të ndryshimeve klimatike. Shqipëria në Kontributin Kombëtar të Synuar është angazhuar për reduktimin e çlirimit të gazeve. Sot në Shqipëri vetëm 3% e automjeteve qarkullojnë me gaz. Qeveria shqiptare po konsideron vendosjen e akcizës për gazin. Unë kërkoj të

rishikohet ky qëndrim, për këtë lëndë (gazin e automjeteve), pasi në të kundërt duke mos stimuluar përdorimin e tij, ne nuk do të jemi në gjendje të mbajmë këtë angazhim që kemi marrë” – theksoi ai gjatë fjalës së tij.

Shqipëria në paketën e masave që synon reduktimin me 11.5% të gazeve me efekt serrë ka parashikuar investimet që lidhen me 3 nga fushat kryesore që ndikohen nga ndryshimet klimatike dhe është llogaritur dhe kostoja që kanë këto investime në të tre fushat që ndikojnë në krijimin e këtyre gazeve me efekt serrë. Kështu tre janë fushat prioritare që duhet të ndërmerren politika dhe investime, që të minimizojnë shkarkimet në ajër: fusha e ndërtimit me kosto për afërsisht 21 milionë Euro; fusha e industrisë me kosto për afërsisht 15 milionë Euro dhe fusha e transportit, ku investimet për të arritur objektivat e planifikuara kanë një kosto të llogaritur prej 651 milionë Euro.

Në fushën e Transportit zërat e parashikuara në këtë paketë për të realizuar angazhimin e marrë janë si më poshtë:

- (i) Përdorimi deri në 10% i lëndëve djegëse biokarburante
- (ii) Zëvendësimi i lëndëve të lëngshme djegëse me gazin natyror
- (iii) Përmirësimi i flotës së automjeteve hyrja në vend e automjeteve që plotësojnë standardet e BE-së. Kostoja totale e këtyre masave për deri në vitin 2030 është rreth 687 milion Euro.

## HUNGARIA DO E MBËSHTETË SHQIPËRINË NË FUSHËN E MJEDISIT



Ministri i Mjedisit, Z. Lefter Koka priti Ministrin e Shtetit dhe të Bujqësisë së Republikës Hungareze, Z. Zsolt V. Németh.

Gjatë takimit Ministri Koka e njohu homologun e tij me zhvillimet dhe reformat e marra në vitet e fundit në Shqipëri, si dhe mbi politikën mjedimore që qeveria shqiptare ka ndjekur në këto tre vite, duke ritur vëmendjen me politikën që po ndërmerret në fushën e Mjedisit.

Më tej Ministri Koka bëri një pasqyrë të arritjeve kryesore në këtë fushë, duke vënë theksin në përafrimin me sukses të legjislacionit shqiptar mjedisor me atë të BE-së, gjithashtu prezantoi dhe një sërë reformash administrative që ishin ndërmarrë në këto vite. Ai theksoi se fokusi kryesor i punës së Ministrisë në vitet e fundit është dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve, një nga sektorët ende më problematikë në mjedisin shqiptar. Ai veçanërisht u ndal në investimet e ndërmarrja nga qeveria shqiptare në këtë sektor. Gjithashtu, Ministri Koka veçoi si një ndër arritjet kryesore angazhimin e Shqipërisë në adresimin e çështjeve klimatike, ku përmendi firmosjen e Marrëveshjes e Parisit dhe dorëzimin brenda afateve të Kontributit Kombëtar të Synuar nga ana e qeverisë shqiptare.

Ministri Koka, gjatë konferencës për shtyp theksoi se: “Hungaria do të japë mbështetjen e saj ndaj Shqipërisë në procesin e çeljes së negociatave të

Shqipërisë me Komisionin Evropian. Ftojme investitorët hungarezë në Shqipëri në fushat e mjedisit dhe bujqësisë. Shqipëria është një vend i bukur me bukuri e burime natyrore, një vend potencial për thithjen e turistëve në vendin tonë, prioritet.

Nga ana e tij, ministri hungarez, shprehu mbështetjen e Hungarisë në procesin e çeljeve të negociatave nga Komisioni Evropian.

Ministri hungarez Németh, gjatë konferencës për shtyp theksoi se “Hungaria është e interesuar për integrimin e Shqipërisë, sepse kjo ndihmon edhe bashkëpunimin midis dy vendeve. Hungaria ka një eksperiencë të gjatë në mbrojtjen e mjedisit, të vlefshme për t'ia ofruar edhe Shqipërisë. Në fushën e bashkëpunimit dypalësh gjatë takimit u diskutua se edhe Hungaria mund të përfitojë nga Shqipëria në procesin e ndryshimeve klimatike. Gjithashtu Ministri Hungarez i shteti u shpreh se dhe institucionet shkencore dhe akademike mund të forcojnë frymën e bashkëpunimit veçanërisht në fushën e pyjeve”.

Takimi u fokusua dhe në diskutimin mbi procesin e çeljes së negociatave të Shqipërisë nga Komisioni Evropian, i cili pak javë më parë rekomandoi hapjen e negociatave për anëtarësimin me Shqipërinë. Ministrin Németh i siguroi Ministrin Koka mbështetjen dhe angazhimin e Hungarisë si vend anëtar në BE, për hapat dhe procesin, që do të kalojë

Shqipëria gjatë këtij procesi.

Ministri Koka e ftoi homologun e tij, që të nxisë investitorët hungarezë mbi mundësitë e shumta që ata kanë në vendin tonë në fushën mjedimore, dhe nga ana tjetër dhe nxijen e turistëve hungarezë të vizitojnë Shqipërinë dhe të kenë mundësi që të shijojnë natyrën e bukur shqiptare, me të gjitha vlerat që ajo ofron.

Homologu hungarez Németh shprehu gatishmërinë për të ritur bashkëpunimin midis dy vendeve, veçanërisht në fushën e Mjedisit për rritjen e cilësisë së ajrit apo menaxhimin e integruar të mbetjeve, por edhe të ekoturizmit në zonat e mbrojtura dhe të mundësive për eksportin e produkteve shqiptare bujqësore.

Në përfundim të këtij takimi Ministri Koka kërkoj nga Hungaria, mbështetjen për dhënie e përvojës më të mirë hungareze në fushën e ekspertizës mjedimore dhe ngritjes së kapaciteteve pranë institucioneve të varësisë, me qëllim rritjen cilësore të performancës së tyre.

Palët diskutuan mbi mundësinë e bashkëpunimit, financimeve dhe investimeve në fushën e Mjedisit dhe ato të bujqësisë dhe ekoturizmit, duke garantuar rrugën drejt një zhvillimi të qëndrueshëm për vendin tonë.

*“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimin të cilësisë së jetës dhe të integritimit të vendit në Bashkimin Evropian. Përmbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik”.*

NË KËTË NUMËR:

MINISTRI I MJEDISIT MBRON PROJEKTBUXHETIN E 2017 PËR FUSHËN E MJEDISIT - FQ 1

VJON KONTROLLI PËR MBETJET SPITALORE — FQ 2

VJONË DËGJESAT PUBLIKE PËR DRAFT LIGJIN E ZONAVE TË MBROJTURA— FQ3

AKTIVITETE NË FUSHËN E NDËRBJEGJËSIMIT TË PUBLIKUT — FQ 4

## VIJON KONTROLLI PËR MBETJET SPITALORE

I Inspektoriat Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve ka si objekt të punës së tij edhe kontrollin mbi mbetjet spitalore. Fillimisht gjatë muajit Prill, inspektoriat i përqëndrua tek identifikimi i subjekteve që gjeneronin mbetje spitalore. Nga kontrolli i ushtruar u identifikua se në vendin tonë ishin 750 subjekte që gjeneronin mbetje spitalore. Nga këto subjekte vetëm 459 kishin nevojë të aplikonin pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për t'u pajisur me leje mjedisore.

Pas disa muajsh filloi faza e dytë e këtij inspektimi, i cili konstatoi se nga 459 subjekte, që duhet të pajiseshin me leje mjedisore vetëm 201 prej tyre tashmë janë pajisur me këtë leje. Ajo që vihet re është se kryesisht më problematike në pajisjen me leje

mjedisore janë subjektet shtetërore. Gjatë kontrollit të ushtruar në këtë fazë u konstatuan shkelje dhe u vendosën 5 gjoja me një vlerë 3.600.000 lekë.

Në fillim të muajit nëntor gjatë kontrollit që po ushtrohej në një nga kompanitë që trajtonte mbetjet spitalore, Drejtori i Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, z. Ergys Agasi deklaroi se "Faza e dytë e këtij inspektimi do të përqëndrohet në subjektet e licencuara për trajtimin e mbetjeve spitalore, ku do të kontrollohet jo vetëm mënyra e trajtimit të këtyre mbetjeve, sasia që trajtohet, por gjithashtu do të kontrollohet dhe mënyra se si transportohen këto lloj mbetjesh". Gjithashtu, z. Agasi kërkoi nga Ministria e Shëndetësisë që të tregonte kujdesin e nevojshëm për të gjitha subjektet shtetërore që ishin në

varësi të kësaj ministrie dhe trajtonin mbetjet spitalore, pasi jo vetëm që duhet të pajisen me leje mjedisore, por duhet të plotësojnë dhe kushtet për trajtimin e tyre, sipas legjislacionit që operon në këtë fushë. Gjithashtu, Ministria e Shëndetësisë duhet të parashikojë në buxhetin e 2017 dhe zërin për trajtimin e këtyre mbetjeve që krijohen gjatë punës së institucioneve spitalore shtetërore". Drejtori i Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve theksoi se ky institucion do të ushtrojë të gjithë të drejtat që i jep ligji, për sigurimin e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë shtetasit shqiptarë, si dhe do të penalizojë të gjithë ato institucione shtetërore, subjekte private apo individë që do të ushtrojnë aktivitet në kundërvajtje me ligjet dhe standartet e lejuara mjedisore duke dëmtuar shëndetin e tyre.

## TË PROMOVOJMË ZONAT TONA TË MBROJTURA



Gjatë një vizite në Parkun Kombëtar të Prespës, Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka, ka bërë thirrje në rrjetet sociale për të shijuar këto bukuri që ofron mjedisi shqiptar. Ja si shprehet z. Koka në faqen e tij të facebook-ut:

"Të nderuar Miq, sot zgjedhëm të kalonim familjarisht të dielën tonë, në mrekullinë e Parkut Kombëtar të Prespës; Destinacion i veçantë i turizmit

3.5 milionë euro është projekti 4-vjeçar që firmosëm në fillim të këtij viti, kontribut i qeverisë gjermane, grant për rezervatin e biosferës, që do të shkojë për zhvillimin e zonës e fuqizimin ekonomik të komunitetit të enca unike. Prespës. Ne e njohim ende pak vendin tonë, ndaj Natyrës në Prespë kanë nevojë për mbrojtje dhe mirëadministrim, qytetarët shqiptarë dhe drejtohen drejt mirëadministrimit, mrekullive me të cilat Zoti na ka bekuar e të gjithë ne për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të saj.

## MINISTRI I MJEDISIT KOKA PRET DREJTORESHËN E PËRGJITHSHME TË UNDP-SË SHQIPËRI

Ministri i Mjedisit Z. Lefter Koka priti në takim Znj. Lirija Eltayeb, Drejtoreshën e Përgjithshme të UNDP-së Shqipëri.

Ministri Koka e njohu nga afër Znj. Eltayeb me zhvillimet më të fundit në fushën e Mjedisit në vendin tonë, si dhe prioritetet dhe objektivat kryesore të Ministrisë, ku veçoi reformat e thella administrative të ndërmarrura, që sollën ngritjen e tre institucioneve; Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, si dhe reformat madhore të marra për mbrojtjen e Mjedisit, si moratoriumet në fushën e pyjeve dhe gjuetisë.

Ai, gjithashtu, njohu zj. Eltayeb me nismat më të fundit të qeverisë shqiptare në një nga sektorët më problematikë të Mjedisit, siç është menaxhimi i mbetjeve. Ministri Koka theksoi

gjithashtu se Shqipëria në prag të çeljes së negociatave, ka në fokus mjedisin ku Ministria në grupin e punës ka angazhuar ekspertët më të mirë të fushës

Në vijim, Ministri Koka e njohu Znj. Eltayeb me procesin e përafërimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së në fushën e mjedisit, ku është bërë një progres i dukshëm, e ku një nga ligjet e reja që po hartohen është dhe ligji i ri i Zonave të Mbrojtura, i cili sapo ka përfunduar fazën e konsultimit me palët e interesuara dhe publikun e gjërë.

Nga ana e saj, Zj. Eltayeb e emëruar në krye të UNDP Shqipëri prej një muaji përgëzoi Ministrin Koka në punën e bërë në këto vite, duke u ndaluar veçanërisht në nismat e rëndësishme në mbrojtjen e natyrës siç ishin moratoriumi në fushën e pyjeve dhe gjuetisë, masa administrative, që ajo i konsideroi si domosdoshmëri për

situatën, ku Mjedisi është aktualisht në Shqipëri. Ajo gjithashtu përgëzoi Ministrin Koka për angazhimin e Shqipërisë në COP21 nëpërmjet dorëzimit në kohë të Kontributit Kombëtar të Synuar, si dhe përgatitjen e dokumentit politik Komunikimi i Tretë Kombëtar të Republikës së Shqipërisë, mbi ndryshimet klimatike. Zj. Eltayeb shprehu angazhimin e saj për bashkëpunim edhe më intensiv dhe mbështetjen e UNDP në çështjet mjedisore në Shqipëri.

Në fund të takimit të dyja palët shprehën besimin në vazhdimësinë e bashkëpunimit në të gjitha fushat e mjedisit dhe në veçanti për zonat e mbrojtura. Ministri Koka nënvizoi se zonat e mbrojtura duhet të jenë në funksion të qytetarëve dhe duhen mbështetur me investime serioze, për t'i shndërruar ato në zona tërheqëse për turistin e huaj dhe vendas.

## VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS 2016

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi	Hartoi
1	R.B.ITALBETON	VP "Ndërtim impiant fraksionimi inertesh" Bashkia Vlorë	Rr. "Damian Humariti", Bashkia Vlorë	Vendim për VNM Paraprake	Lura Studio
2	Invictus	VP "Projekt zbatimi i HEC-it Bregu i Lerës" në përronin e Mezhoranit, Tepelenë	Tepelenë, Qarku Gjirokastrë	Vendim për VNM Paraprake	Andrin Kërpaçi
3	GIB	VTH Shfrytëzim mineral gure gelqeror me karriere	Bicaj, Kukës	Plotësim Informacioni	Studio Projekt
4	Albanian Stone Factory	VP Stabiliment perpunim prodhim guri	Bulgarec, Korçë	Vendim për VNM Paraprake	Demir Kullolli
5	Bashkia Korçë (FZHSH)	VP Qëndër polifunkionale e shërbimeve, kreativitetit dhe kulturës në qytetin e Korçës	Bashkia Korçë	Vendim për VNM Paraprake	Arben Muha
6	Pali	VP Qëndër multifunkionale kërkimore për zhvillimin e turizmit (Kompleks turistik)	Lugina e Patokut, Laç, Lezhë	Vendim për VNM Paraprake	Lura Studio
7	Vilson Masmalaj	VTH Kompleks blegtoral	Bërdicë, Shkodër	Deklaratë Mjedisore	Eko Studio
8	Altin Ceci	VP Prodhim pije alkooolike	Gurishte, Maliq, Korçë	Shkresë	Demir Kullolli
9	Milenum	VP Prodhim betoni	Pojan, Korçë	Vendim për VNM Paraprake	Gavrosh Zela
10	Bashkia Himarë	VP "Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura"	Dhralë, Himare, Vlorë	Vendim për VNM Paraprake	Liljana Vllamasi
11	Enti Kombëtar i Banesave	VP Objekt Banimi social 6 kt	Bashkia Durrës	Vendim për VNM Paraprake	Razie Naipi
12	Bashkia Divjake	VP Rikonstruksion shkollë	Cerem, Divjakë	Vendim për VNM Paraprake	Gjergj Liçi
13	MTI	VP Kolektori e impianti i ujërave te zeza	Gjiri i Lalëzit, Durrës	Vendim për VNM Paraprake	Eko Studio
14	Bonita	VP Rikonstruksion dhe shtese shërbimi, parkim hoteli	Golem, Kavajë	Vendim për VNM Paraprake	Hamdi Hoti
15	Umranije	VP Konvikt humanitar	Pukë, Shkodër	Vendim për VNM Paraprake	Lura Studio
16	D&A	VP Ndërtim kapanoni industrial 1 kat	Bashkia Shijak, Durrës	Vendim për VNM Paraprake	Nevjana Isufi
17	VËLLEZËRIT HYSA	VTH "Shfrytëzim i gurit gelqeror në sipërfaqen shtesë të lejes minerare nr.1304/2, objekti 'Rrezlik'	Elbasan	Vendim për VNM të Thelluar	Studime Projektme Gjeologji -Inxhinjerike Hidrologji Mjedisore
18	VËLLEZËRIT HYSA	Shfrytëzim i inerteve lumore në zonën Pazhok" lumi Devoll,	Elbasan	Plotësim Informacioni	Studime Projektme Gjeologji -Inxhinjerike Hidrologji Mjedisore

## SHQIPËRIA PREZANTON KOMUNIKIMIN E TRETË KOMBËTAR NË TAKIMIN E 22 TË PALËVE TË KONVENTËS PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE



Në muaji Nëntor në Marakesh të Marokut u zhvillua takimi i 22-të i Palëve të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Në një takim të posaçëm të organizuar nga Sekretariati i Konventës, përfaqësuesit e delegacionit të vendit tonë prezantuan Komunikimin e Tretë Kombëtar për Ndryshimet Klimatike për Republikën e Shqipërisë.

Ky Komunikim, dokument i finalizuar, botuar dhe dorëzuar së fundmi, u prezantua në Tiranë më 18 Tetor 2016, nga Ministri i Mjedisit, Z. Lefter Koka dhe Përfaqësuesi i Përhershëm i PNUD-it në Tiranë, z. Brian Williams, si pjesë e plotësimit të detyrimit të vendit tone.

Për hartimin e Komunikimit të Tretë Kombëtar, të Ministrisë së Mjedisit, Republika e Shqipërisë, u mobilizuan një sërë ekspertësh kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e ndryshimeve klimatike, si edhe aktorë nga institucione kombëtare, përfaqësues akademike dhe shoqëria civile, për të siguruar përputhjen e objektivave me prioritetet zhvillimin e vendit, në përputhje të plotë me metodologjinë ndërkombëtare.

Ky dokument, që u prezantua në COP22, Marok nga delegacionin e Ministrisë së Mjedisit përmban një inventar të shkarkimeve

të gazeve me efekt serrë (GES) dhe të flukseve të tyre, si dhe përshkruan kapacitetet e Shqipërisë për të kontribuar në zbutjen e këtyre ndryshimeve dhe aftësitë e saj për t'u përshtatur me këto ndryshime.

Ky dokument nxjerr në pah se ndryshe nga viti 2005 ku kontribues kryesorë të shkarkimeve ishin sektorët e energjisë/transportit që zinin 52,28% të shkarkimeve të përgjithshme në vitin 2005, të ndjekur nga bujqësia (15,83%), proceset industriale (12,61%), NPITP (11,91%) dhe mbetjet (7,37%), në periudhën 2008-2009, shkarkimet nga sektori i NPITP-së janë ulur ndjeshëm, ndërkaj saktori i proceseve industriale po i rrit shkarkimet e tij.

Për vlerësimin e Cënueshmërisë dhe Përshtatjes (C&P), Komunikimi i Tretë Kombëtar ka hartuar Planin e Përshtatjes për Zonën Bregdetare duke marrë në konsideratë sektorët më të prekshëm si: furnizimi me ujë, bujqësia, blegtoaria, pyjet, kulturat bujqësore, biodiversiteti, turizmi dhe popullsia, dhe shëndeti, ku vija bregdetare mund të ketë tendencë në rritje të temperaturave si shkak i ndryshimeve klimatike.

Prezantimi i ekipit shqiptar u prit me mjaft interes, në veçanti gjetjet, rekomandimet e prezantuara, si edhe vazhdimësia e projektit.

Tejet i rëndësishëm u vlerësua integrimi i tyre në strategjitë dhe politikat sektoriale në vendin tonë, dhe paraprirja e identifikimit/përthithjes së fondeve për projekte të reja zhvillimi, dhe ndërtimi i kapaciteteve.

Komunikimi i Tretë Kombëtar ka integruar për herë të parë çështjet gjinore, ku është projektuar një udhëzues gjithëpërfshirës për integrimin e çështjeve gjinore në programet dhe planet e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri.

Tashmë Shqipëria është gati të përcaktojë prioritetet të reja në përputhje me zhvillimet kombëtare dhe ato ndërkombëtare në frymën e Marrëveshjes së Parisit, në fuqi prej 4 Nëntor, 2016.

Punimet e COP 22 u mbyllën më 18 Nëntor, 2016 me vendime të rëndësishme, që do të mundësojnë zbatimin konkret të Marrëveshjes së Parisit - COP 21.

Hartimi i Komunikimit të Tretë Kombëtar, Ndryshimet Klimatike në Republikën e Shqipërisë është një dokument i Ministrisë së Mjedisit me sipërmarrje të përbashkët me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri - UNDP, në kuadër të mbështetjes së ofruar nga Fondi Global për Mjedisin ,GEF.

## VIJONË DËGJESAT PUBLIKE PËR DRAFT LIGJIN E ZONAVE TË MBROJTURA



Në vijim të disa dëgjesave publike të zhvilluara gjatë javëve të kaluara në disa qytete të vendit, në Shkodër, Vlorë, dhe Librazhd, Ministria e Mjedisit organizoi më datë 31.10.2016, dëgjesën publike për projektligjin "Për Zonat e Mbrojtura", me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqatave mjedisore, ekspertëve të pavarur mjedisorë, përfaqësues të qeverisjes vendore, shoqërisë civile, etj.

Projektligji i ri ka për qëllim përmirësimin e kornizës aktuale ligjore për ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura, duke sjellë disa risi, të cilat vijnë si rrjedhojë e nevojave për zgjidhje të veprimitarive që ushtrohen dhe kërkohet të zhvillohen në Zonat e Mbrojtura, por edhe në vijim të krijimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

Ky projektligji ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin, përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përmbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale kulturore, në interes të të gjithë shoqërisë, si dhe përcaktimin e përgjegjësisë të institucioneve publike, dhe personave fizik/juridik privat për ruajtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të tyre nëpërmjet evidentimit, përcaktimit dhe shpimit të zonave të mbrojtura ose

zgerimit të atyre ekzistuese; sigurimit, ruajtjes dhe ripërtëritjes së habitateve natyrore, të llojeve, të rezervave dhe të peisazheve natyrore brenda zonave të mbrojtura; përdorimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura, duke integruar elementet e tij në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.

Qëllimi i këtij projektligji është të sigurojë mbrojtje të veçantë të zonave të mbrojtura dhe përbërësve të rëndësishëm të biodiversitetit dhe të natyrës në to, nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura, me rëndësi të veçantë për vlerat e tyre natyrore, ekonomike apo sociale, si pjesë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të mjedisit; zhvillimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura, pasuri kombëtare me rëndësi të veçantë për vlerat e rralla e të pazëvendësueshme të ekuilibrave natyrorë, biodiversitetit si detyrim në interes të brezave të sotëm dhe të ardhshëm; lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit mjedisor; informimin dhe edukimin e publikut për gjendjen dhe dobishmërinë e zonave të mbrojtura.

Ky projektligji mbështetet në tërësinë e tij në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, parimin e integritimit, parimin "ndotësi paguan" dhe parimin e parandalimit dhe marrjes së masave paraprake.

Me qëllim planifikimin dhe menaxhimin e kujdesshëm të burimeve të tokës, ajrit, ujit, florës dhe faunës, që ato të ruhen

për të mirën e brezave të sotëm dhe të ardhshëm, nëpërmjet zhvillimit që plotëson nevojat e tashme, pa kërcënuar nevojat e brezave të ardhshëm.

Sipas projektligjit, strukturat përgjegjëse për menaxhimin e zonave të mbrojtura përfshijnë:

Ministrinë e Mjedisit, si politikëbërës;

AKZM, si institucionin qendror shtetëror përgjegjës për administrimin, menaxhimin dhe kontrollin e ZM;

AdZM-të (Administratat Rajonale të ZM), si institucione në varësi të AKZM-së me seli në çdo qark, që zbatojnë detyrat për mbrojtjen dhe zhvillimin e ZM që ndodhen në qark; administratat e ZM, si organi shtetëror që ngarkohet për administrimin e kontrollin e një zone të mbrojtur; bashkitë, si autoritete që zbatojnë kërkesat e këtij ligji dhe të ligjeve të tyre organike në lidhje me ZM brenda territorit administrativ të tyre, si edhe Komitetet e Menaxhimit, që drejtohen nga prefektët.

Në javët në vazhdim do të vijojë mbajtja e disa dëgjesave publike edhe në qytete të tjera të vendit, me qëllim konsultimin sa më të gjerë të këtij projektligji shumë të rëndësishëm.

## FESTIVALI I PARË I ZOGJVE NË SHQIPËRI



Më 27-28 Nëntor në EXPOCITY në City Park Tiranë u zhvillua Festivali i parë i zogjve në Shqipëri.

Në këtë Festival të organizuar nga Shoqata "Mbarëshpuesit e Kanarinave"(MK) në Shqipëri, në bashkëpunim me Shoqatën e Ornikuturës së Pulias në Itali dhe mbështetur nga Ministria e Mjedisit u mundësua ekspozimi i mbi 1000 zogjve të klasifikuar në mbi 300 raca të ndryshme.

I pranishëm në këtë aktivitet të parë të kësaj natyre, ishte zëvendësiministri i Mjedisit, z. Kledi Xhaxhu i cili përgëzoi organizatorët dhe theksoi se ky është "Aktiviteti i parë në nivel ndërkombëtar në Shqipëri dhe ka për qëllim ndërgjegjësimin e publikut dhe mbarëshpuesit në veçanti për të drejtat dhe detyrat që ushtrohen në hobi e mbarëshpimit të zogjve në zbatim të legjislatonit shqiptar."

Aktiviteti i shërben mbarëshpimit të specieve të kultivuara, sidomos atyre që rrezikohet të zhduken nëse nuk mbështetën nga kultivimi artificial (nga njeriu) siç është lloji i kanarinës së butë, për të ruajtur dhe zhvilluar këto specie që janë një dëshmi e gjallë e përpjekjeve qindrvjeçare të kultivuesve të pasionuar, për ruajtjen e larmisë biologjike të specieve që nuk mund të riprodhohen në kushte natyrore."

Gjyqarët dhe ekspertë të huaj kanë shpjeguar se kjo është e para ekspozitë ornitologjike në Shqipëri, dhe shpresohet, që së shpejti të shndërrohet në një traditë të përvitshme.

Festivali i parë i zogjve synon të sjellë në Shqipëri eksperiençën e vendeve të tjera evropiane duke synuar që të mbështesë dhe përhap pasionin, dashurinë dhe njohuritë për kanarinat e racat e tyre nëpërmjet ekspozimit të arrijeve të mbarëshpuesve shqiptarë dhe më gjerë në rajonet fqinje. si dhe të formalizojë kultivimin e specieve me vlera ndërkombëtare, si dhe të

nëngrupit të kanarinave gjysmë endemike të vendit.

Shoqata e Ornikuturës së Puglias, ka sjellë në Shqipëri të gjitha racat e kanarinave individët fitues në aktivitetet ndërkombëtare.

Një grup i përbërë nga personalitete të ornitologjisë italiane, gjyqarë ndërkombëtarë dhe ekspertë të racave të ndryshme të kanarinave kanë marrë pjesë në këtë festival. Të pranishëm ishin edhe mbarëshpues nga Kosova, Maqedonia, Malit i Zi dhe Greqia. Festivali u zhvillua dy ditë dhe gjyqarët dhanë edhe çmime për speciet më të mira.





“Nëse do vazhdojmë të mos dëgjojmë dhe të mos ndryshojmë, do të na duhet një mjedis i ri”

Beth Moor

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT  
Email: info@moe.gov.al

## AKTIVITETE NË FUSHËN E NDËRGJEGJËSIMIT TË PUBLIKUT



**M**inistria e Mjedisit në bashkëpunim me projektin e UNDP - “Krijimi i Sistemit të Informacionit për Menaxhimin

dhe Monitorimin Mjedisor në Linjë me Raportimin Global (EIMMS)” zhvilloi një orë të hapur për biodiversitetin, me shkollën nëntëvjeçare “Riza Spahiu” të qytetit të Kukësit.

Në këtë orë të hapur mësimore u mbajt një prezantim mbi programin Kombëtar të Edukimit Mjedisor dhe Konventën e Aarhusit, ku nxënësve iu shpjegua vendi që duhet të zërë mjedisi, jo vetëm në kurrikulat mësimore, por dhe në kthimin në sjellje të tyre të përditshme kujdesi ndaj asaj që i rrethon. Në shpjegimin e Konventës së Aarhusit iu kushtua rëndësi njohjes së parimeve të demokracisë që kjo Konventë përçon në çështjet mjedisore, të drejtat që fëmijët si qytetar të këtij vendi duhet të ushtrojnë për të njohur mjedisin që i rrethon, të drejtën që kanë për t’u bërë pjesë e vendimeve që ndërmerren drejtuesit e qytetit të tyre, por që ndikon në mjedisi.

Prezantimi i dytë që një pamje e përgjithshme e mbi biodiversitetin në Shqipëri, pasuria e florës dhe faunës në vendin tonë, por specifikisht flora dhe fauna e zonës së Kukësit. Gjithashtu, një vend i veçantë iu kushtua gjatë prezantimit edhe kategorizimit të zonave të mbrojtura dhe nivelit të mbrojtjes që tregohet për këto zona sipas kategorizimit.

Prezantimi i tretë u mundësua nga znj. Odeta Çato, Kordinatore e Projektit EIMMS, ku u prezantua koncepti i “Qytetarit Shkencëtar”, si pjesë e aktivitetit BioBlitz <http://nationalgeographic.org/projects/biolblitz/education/>;

Pas prezantimeve të bëra në klasë, nxënësit dolën në oborr dhe në zonën përreth shkollës, për të gjetur dhe identifikuar disa nga llojet që gjendenishin aty. Nxënësit të ndihmuar dhe nga specialistët që ishin pjesë e projektit i fotografonin këto specie, dhe më pas i shkarkuan në një aplikacion, i cili mbledhte të dhëna nga flora e fauna në të gjithë botën. Kjo do të ndihmonte në rritjen e njohurive për speciet në mjedisi të ndryshme si dhe përdoruesit do përfitonin njohurive të reja mbi speciet në mbarë botën, njohuri të cilat mund t’i përdornin gjatë prezantimeve apo punimeve shkencore kurdo që mund t’ju nevojiten.

Projekti EIMMS i dhuroi shkollës paisje laboratorike për lëndën e biologjisë si mikroskop, paisje për konservimin dhe paraqitjen e faunës dhe florës, që do të gjendej në zonën e tyre.

Ky aktivitet do të shtrihet në rreth 20 qytete të Shqipërisë gjatë vitit akademik 2016-2017.

Do jenë rreth 20 shkolla dhe mbi 200 fëmijë që do jenë pjesë e këtij projekti që shërben për të monitoruar mjedisin nga vet qytetarët e këtij mjedisi.



Qendra e Informacionit Aarhus Shkodër, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, organizoi me datë 16 nëntor, aktivitetin me temë: “Informimi dhe pjesëmarrja publike në çështjet e Mjedisit, detyrë dhe përgjegjësi institucionale”.

Në kuadër të projektit “Roli i shoqërisë civile për të lobuar në zbatimin dhe përmirësimin e legjislacionit mjedisor në Qarkun Shkodër” i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian nëpërmjet programit ACHIEVE të zbatuar nga REC Shqipëri.

Në këtë veprimtari morën pjesë kryetarët e Njësisë Administrative të Bashkisë Shkodër ashtu si dhe drejtoritë e ndërlidhura me mjedisin në këtë bashki, respektivisht Drejtoria e Mjedisit, Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Emergjencave Civile dhe koordinatori i të drejtës për informimin e publikut në Bashkinë e Shkodërës.

Gjithashtu, të pranishëm ishin edhe përfaqësuesi i REC Shqipëri, Z. Indrit Kodra, i cili u prezantoi pjesëmarrësve programin ACHIEVE ashtu si dhe

përfaqësuesja e Qendrës EDEN, Znj. Herda Paco, e cila prezantoi rastin konkret të mobilizimit të shoqërisë civile për Lumin e Valbonës duke ndjekur pikërisht rrugën ligjore mjedisore.

Gjatë aktivitetit u prezantua kuadri ligjor për të drejtat e qytetarëve dhe detyrimin institucional për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në çështjet e mjedisit.

Z. Gjergj Kurti, koordinatori i së drejtës për informim pranë Bashkisë Shkodër prezantoi punën, funksionet e tij ashtu si dhe mënyrën sesi kërkesat për informacion trajtohen pranë kësaj bashkie.

Gjatë aktivitetit u diskutua gjatë me audiencën mbi rëndësinë e përfshirjes së komunitetit për çështjet e Mjedisit. Përsa i përket të drejtës për pjesëmarrje në vendimmarrje mjedisore, shumë nga të pranishmit theksuan faktin që ka një reagim të ulët të shoqërisë civile dhe komunitetit për të marrë pjesë në dëgjuesat publike për investime me ndikim në mjedisi, dëgjuesat shpesh vuajnë nga formalizimi.

Në përgjigje të këtyre shqetësimeve, pjesëmarrësit propozuan disa sugjerime për përmirësimin e zbatimit të principeve të Konventës së Aarhusit, ku më të rëndësishmet shprehen si më poshtë:

- Bashkia Shkodër ka në projekt që të zhvillojë një sistem të brendshëm ndërmjet bashkisë dhe njësisë administrative të saj për trajtimin sa më të shpejtë dhe efikas të kërkesave të qytetarëve. Ky sistem është i ngritur por momentalisht funksionon vetëm me Njësitë Administrative të Velipojës dhe të Dajçit. Së shpejti pritet të përhapet dhe në njësitë e tjera;
- Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të administratës publike për detyrimet që ajo ka për zbatimin e të drejtës për informim dhe pjesëmarrje në çështjet e mjedisit;
- Aktivizimi më i lartë i shoqërisë civile për t’u përfshirë në çështjet e caktuara mjedisore duke ndjekur deri në fund rrugët ligjore;
- Informimi dhe sensibilizimi i brezave të rinj për t’u njohur dhe për të kërkuar zbatimin e këtyre të drejtave.